Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0863

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së në përbërjen nga; Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Internacional Group Base" Sh.P.K., kundër Vendimit për dhënie te një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-5718-2-1-1, të Policisë se Kosovës ne cilësi te AK, më 22/01/2024, mori këtë:

Vendim

1.Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Operatorit ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K, me nr:2023/0863, datës, 02/11/2023, kundër, "Njoftim mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së", me numër të prokurimit; 214-23-5718-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

2.Vërtetohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" i datës, 14.08.2023, AK-Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1, të dispozitivit.

3.Konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndaj operatorit ekonomik ankues "Internacional Group Base" Sh.P.K., bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.06.2023 "Policia e Kosovës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar, Njoftimin për Kontratë B05, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së" me numër të prokurimit; 214-23-5718-2-1-1. Ndërsa me datën, 14.08.2023, AK ka publikuar, B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë

OE “MSS Mobile Sanitary Services” Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,969,331.89€.

Me 21.08.2023, OE “Internacional Group Base” Sh.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Internacional Group Base” Sh.P.K., me nr. 863/23 lidhur me aktivitetin “Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së” me numër të prokurimit 214-23-5718-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Internacional Group Base” Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I): “Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar dhe kemi plotësuar kërkesën e DT dhe me datë 15.08.2023 për qudi kemi marrë vendim për tenderuesin e eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar foto apo dëshmi të mjaftueshme, por ju me qëllim të dëmtimi të Kompanisë tonë nuk keni kërkuar sqarime kurse keni përdorur standarde të dyfishta pasi që për OE e rekomanduar për kontratë. Përdorimi i standardeve të dyfishta përdori sa OE të rekomanduar keni kërkuar sqarime lenë për të dyshuar se ka keqpërdorime në këtë AP ne pas qasjes jemi duke analizuar Ofertën e OE dhe brenda afatit ligjorë, do e plotësojmë atë. Arsyetimet e AK se nuk kemi ofruar makineri të mjaftueshme është krejtësisht se e pavërtetë pasi që në ofertën tonë kemi bashkangjitur të gjitha dëshmitë sipas kërkesave dhe mungesa e fotove nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e cila ka mundur të sqarohet. Arsyetimet tuaja janë krejtësisht të pabazuara. Arsyetimi i AK për eliminimin e ofertës tonë është i pabazë pasi që në ofertë ekzistojnë të gjitha makineritë e kërkuara dhe mos kërkimi i fotove i bie standard i dyfishtë pasi që vetë AK OE të rekomanduar i ka kërkuar dhe pse Brenda për Brenda ofertës dëshmohet se ky OE është i papërgjegjshëm për arsye se: Pas analizës së ofertave ne pamë që OE i rekomanduar ka ofruar një Marrëveshje me një biznes Smajl Jakupaj B.I. me nr. 810448557 i cili del të jetë i shuar dhe dokumenti i tille llogaritet si mashtrim dhe është jo valid që e bënë ofertën të papërgjegjshme. Pra biznesi është i shuar me datë 11.05.2023 dhe OE ka marrëveshjen e nënshkruar me datë 22.06.2023. Edhe pse ne kemi ofruar argumente AK nuk ka vepruar konform me LPP dhe vendimin tuaj si OSHP ku keni kërkuar që të bëhet rivlerësim por AK pas një muaji në formë krejt të paligjshme merre vendim ndaj kërkesës për ri-shqyrtim pas më shumë se 2 muajve kurse për një kërkesë për ri-shqyrtim afati është maksimumi 6 ditë. Se AK ka bërë shkelje ligjore dhe ka përdorur standarte të dyfishta shifet qartë sepse pa e kthyer lenden në rivlerësim ka kërkuar nga OE i prefruar i saj sqarime kurse saqrime për neve si OE edhe pse ka qenë e Obliguar me vendimin tuaj nuk na kanë kërkuar. Për sa u tha më lartë kërkojmë që të

aprovoni ankesën tonë dhe ta Urdhëroni AK të veproj konform LPP-së. P.S brenda afatit ligjor do e plotësojmë ankesën."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 59, 60, 61, 72 të LPP –së. Duke propozuar që ta aprovoj ankesën tone dhe ta urdhëroj AK te veproj konform LPP-së.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë, 14/11/2023, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 863/23, ndërsa me datë 21/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/0863, me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK."

Lidhur me pretendimet e OE "Internacional Group Base" Sh.P.K Eksperti shqyrtues përmes Raportit nr. 2023/0863 ka vlerësuar si në vijim:

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se kjo procedure e prokurimit ka qene objekt i shqyrtimit ne OSHP, vendimi nr.611/2023 i datës 20/10/2023.

*Konstatimi i parë (I): "*Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.863/23 ka të bëjë me arsyet e eliminimit të OE ankues, ku sipas OE ankues i njëjti është eliminuar me arsyetim se nuk ka ofruar fotografitë e pajisjeve të kërkuara/ofruara. OE pretendon se një gjë e tillë ka mund të plotësohet/sqarohet përmes sqarimeve shtesë, mirëpo AK për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë, për OE ankues nuk ka kërkuar sqarime. Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimorë, dosjes së tenderit, raportit të komisionit vlerësues dhe vendimit të AK-së për eliminim, fillimisht duhet të sqarojmë se mungesa e fotove nuk është arsyeja e vetme për eliminim të OE ankues. Pika e parë e eliminimit të OE ankues sipas AK-së është se i njëjti nuk ka ofruar listën e stafit të nënshkruar dhe vulosur ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, mirëpo ka ofruar një listë të ATK-së për kontributet e paguara. Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues është mungesa e fotove për disa nga pajisjet e ofruara, ku ofrimi i fotove ka qenë kërkesë decidive në dosje të tenderit: "Dëshmi 5:Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi listën e veglave dhe mjeteve të punës qe posedon e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose kontratën ose marrëveshjen për marrjen me qira të automjeteve. Veglat dhe mjetet te dëshmohen me foto." Pika e tretë e eliminimit ë OE ankues ka qenë se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për gjatësinë e kranit. Më konkretisht AK në arsyetim ka potencuar dëshmia për njërin autovinç është për gjatësi 25 metra (më e vogël se ajo e kërkuar në dosje 30 metra), ndërsa për autovinçin tjetër nuk është ofruar dëshmi se sa është gjatësia e autovinçit me korpë. Eksperti shqyrtues vlerëson se parimisht AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues. Megjithatë vlerësojmë se, pa paragjykuar nëse sqarimet e ofruara nga OE ankues do ishin në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe do të arrinin ose jo të dëshmonin plotësimin e kushteve të dosjes, një veprim i tillë nga AK (kërkesa për sqarime ndaj OE ankues) nuk do të sillte ndryshim në rezultat final dhe vendim të AK-së, pasi para OE ankues është edhe një OE tjetër i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Me qenë se OE ankues nuk ka bashkangjitur dëshmi për të cilat pretendon se do ti plotësonte me sqarime shtesë, vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.*"*

Konstatimi i dytë (II): **"** Pretendimi i dytë ankimor sipas ankesës nr.863/23 është se AK, për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë prej të cilit ka kërkuar sqarime shtesë, të njëjtin veprim nuk e ndërmarr edhe ndaj OE ankues, do thotë nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues. OE ankues pretendon se me sqarime shtesë do të dëshmonte se i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së. Eksperti shqyrtues edhe njëherë sqaron se parimisht AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues. Megjithatë vlerësojmë se, pa paragjykuar nëse sqarimet e ofruara nga OE ankues do ishin në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe do të arrinin ose jo të dëshmonin plotësimin e kushteve të dosjes, një veprim i tillë nga AK (kërkesa për sqarime ndaj OE ankues) nuk do të sillte ndryshim në rezultat final dhe vendim të AK-së, pasi para OE ankues është edhe një OE tjetër i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Në cilësi të ekspertit shqyrtues përmes E-Prokurimit kemi kontrolluar nëse OE ankues ka bërë plotësim të ankesës (ashtu siç ka cekur në fund të ankesës), e po ashtu pranë Arkivit të OSHP-së kemi kontrolluar nëse OE ankues ka bërë një veprim të tillë mirëpo nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi shtesë. Me qenë se OE ankues në ankesë në OSHP nuk ka bashkangjitur dëshmi për të cilat pretendon se do ti plotësonte me sqarime shtesë, vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.*"*

Konstatimi i tretë (III): **"** Pretendimi tjetër ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrëveshje me një biznes Ismajl Jakupaj B.I. me nr. 810448557 i cili del të jetë i shuar dhe dokumenti i tillë llogaritet si mashtrim dhe është jo valid që e bënë ofertën të papërgjegjshme. Sipas OE ankues biznesi është i shuar me datë 11.05.2023 dhe OE ka marrëveshjen e nënshkruar me datë 22.06.2023. Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se në rastin konkret kemi të bëjmë me një marrëveshje në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe një kompanisë "Ismajl Jakupaj B.I"" . Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se për këtë çështje AK ka kërkuar sqarime shtesë, dhe OE i rekomanduar ka ofruar sqarime kemi të bëjmë me të njëjtën kompani e cila e ka ndërruar llojin e biznesit nga: Biznes Individual (B.I) me emër "Ismajl Jakupaj B.I" dhe emër tregtar "NTP Medruplast", Në: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SHPK), me emër "Medruplast SH.P.K." dhe emër tregtar "Medruplast", ku prap figuron pronari i njëjtë Ismajl Jakupaj. OE po ashtu ka ofruar "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve, sipas të cilave informata me zbatimin e ligjit për numrin unik identifikues të biznesit me numër unik 810448557 dhe numër biznesi 80098502 me datë 11.05.2023 ky biznes ndërron tipin në "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara" dhe merr numrin e ri të biznesit 812041119 dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm. Provë: Informata mbi biznesin me numrin unik identifikues 812041119 .Provë : të dhënat nga faqja zyrtare e Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit."

Konstatimi i katërt (IV): **"** Pretendimi i fundit sipas ankesës 863/23 është se AK ka bërë shkelje të LPP-së pasi ka vonuar dy muaj kthimin e përgjigjes /vendimit në kërkesë për rishqyrtim. Sqarojmë se pas kërkesës, lënda për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë në OSHP deri me datë 20.10.2023 kur është lëshuar vendimi i OSHP-së nr.611/23. AK me 23.10.2023 (pas tri dite) ka ngarkuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim. Bazuar në faktin se AK-të nuk kanë të drejtë marrin kurrfarë vendimi për aktivitete të prokurimit që janë në procedurë në OSHP, AK ka kthyer përgjigje ndaj OE ankues brenda tri dite pas pranimit të vendimit dhe përfundimit të procedurës në OSHP, andaj vlerësojmë se nuk qëndron pretendimi ankimorë se AK e kanë vonuar dy muaj vendimin në kërkesë për rishqyrtim. Po ashtu vlerësojmë se vendimi i AK-së nuk është në kundërshtimin e me vendimin e OSHP-së siç pretendon OE ankues, pasi vendimi i OSHP-së nr;611/23 e ka kthyer lëndën në rivlerësim me qëllim të trajtimit të pretendimeve ankimore të kërkesës për rishqyrtim nga ana AK-së (obligim të cilin e ka

përmbushur AK).”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik,Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësuese të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të *pabazuara.*

Paneli Shqyrtues vëren se OE ankues është eliminuar sepse i njëjti nuk ka ofruar listën e stafit të nënshkruar dhe vulosur ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, mirëpo ka ofruar një listë të ATK-së për kontributet e paguara. Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues është mungesa e fotove për disa nga pajisjet e ofruara, ku ofrimi i fotove ka qenë kërkesë në dosje të tenderit. "Dëshmi 5: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi listën e veglave dhe mjeteve të punës që posedon e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe të jenë në pronësi të operatorit ekonomik apo kontratën ose marrëveshjen për marrjen me qira të mjeteve të punës. Veglat dhe mjetet të dëshmohen me foto."

Ndër arsyet tjera të eliminimit të OE ankues, është mungesa e përmasave teknike të mjetit punues të kërkuar, OE ka ofruar një autovinç për gjatësi 25 metra, (kërkesa në DT, 30 metra), ndërsa për autovinçin tjetër nuk është ofruar dëshmi se sa është gjatësia e autovinçit me korpë. Eksperti shqyrtues vlerëson se parimisht AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues. Megjithatë vlerësojmë se, pa paragjykuar nëse sqarimet e ofruara nga OE ankues do ishin në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe do të arrinin ose jo të dëshmonin plotësimin e kushteve të dosjes, një veprim i tillë nga AK (kërkesa për sqarime ndaj OE ankues) nuk do të sillte ndryshim në rezultat final dhe vendim të AK-së, pasi para OE ankues është edhe një OE tjetër i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Lidhur me pretendimin ankimor se, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrëveshje me një biznes Smajl Jakupaj B.I. me nr; 810448557 i cili del të jetë i shuar, Paneli sqaron se ka një marrëveshje në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe një kompanisë "Ismajl Jakupaj B.I". AK ka kërkuar sqarime shtesë, dhe OE i rekomanduar ka ofruar sqarime nga të cilat vërehet se OE ka ndërruar llojin e biznesit nga biznes individual në emër tregtar "NTP Medruplast", andaj paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me nenin 72 të LPP-së kur me anë të sqarimeve shtesë ka vërtetuar faktet lidhur me këtë pretendim ankimor, që rezulton se është i pabazuar.

Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me vendimin për aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së", me numër të prokurimit; 214-23-5718-2-1-1, ku ka shpërblyer me kontratë, OE "MSS Mobile Sanitary Services" Sh.P.K. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik "Internacional Group Base" Sh.P.K, dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të datës, 14.08.2023, Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës së OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: